


NË TEATRIN KOMBËTAR EDHE VALLEZOHEJ

Nën petkun shqiptar, pasi kostumet janë inspiruar prej fotove të Marubit, për të parën herë skena shqiptare do të ndjejë peshën e një komedie botërore. "Të marrësh masa të kota" ose siç njihet në original "Berberi i Seviljes" i Beaumarchais, do të vihet në skenë në Teatrin Kombëtar nga data 19 deri më



datë 22 prill. Skena shqiptare, si edhe spektatori do të marrin ndjesinë e "Berberit të Seviljes" ndryshe nga të tjerët, një teatër muzikor i konceptuar si një ngërthim i këngës, valëzimit dhe natyrisht aktrimit. Regjisori i kësaj shfaqjeje është francezi Erik Vinje, të cilit i ka mjaftuar një kontakt me albumet fotografike të dinastisë "Marubi", për të perceptuar një shfaqje me elemente shqiptare. Vinje është përpjekur ta ngjisë në skenë ndryshe kësaj radhe, duke ia përshtatur këtë komedi Shqipërisë. Në pjesën e shkruar para revolucionit, personazhi kryesor është Figaro. Skena është e ndërtuar krejtësisht bardhezi, ku drita dhe hijet janë elementet kryesorë të kësaj komedie. Po ashtu, edhe kostumet tradicionale shqiptare janë bazuar në pasurinë e madhe dhe të veçantë të ikonografisë së Shqipërisë e grumbulluar në Shkodër gjatë viteve 1850 dhe 1950 nga fotografet Marubi. Kostumet janë realizuar nga stilistja Anila Zajmi. Ndriçimi i është besuar francezit Paskal Noel. Vigner dhe Noel kanë arritur të bindin disa teatro kombëtare franceze që t'i dhuronin Teatrit Kombëtar Shqiptar disa materiale ndriçimi.

Në këtë komedi do të interpretojnë aktorë si: Roland Trebicka e Luiza Xhuvani, Helidon Fino e Neritan Liçaj. Ata e kanë provuar tashmë se janë ndër aktorët më të mirë të skenës

shqiptare, por kjo komedi do të jetë një sfidë e madhe për ta, sepse do t'iu duhet edhe të vallëzojnë e këndojnë. Për Xhuvanin, kjo është një eksperience tepër të bukur dhe të vështirë dhe është ajo çka i duhet një aktori, që të mos mbetet vetëm në kornizën e të recituarit, por të dijë të bëjë më shumë.

